



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 25 shtator 2023  
Nr.ref.: RK 2270/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI103/22**

Parashtrues

**Halit Berisha dhe Sahit Berisha**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev.nr. 244/2021, të 20 prillit 2022**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar.

### **Parashtruesit e kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Halit Berisha dhe Sahit Berisha, me vendbanim në Komunën e Prishtinës, të cilët i përfaqëson avokati Selim Nikqi, nga Prishtina (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [Rev.nr. 244/2021] e 20 prillit 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.5441/2017] e 16 tetorit 2020, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr. 1748/2012] e 19 shtatorit 2017, të Gjykatës Themelore në Prishtinë (Në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 1 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përmes postës kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).
7. Më 25 korrik 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban anëtarë.
8. Më 12 korrik 2022, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 12 korrik 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

11. Më 31 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 31 dhjetor 1965, paraardhësi i parashtruesve të kërkesës Avdi Shaban Berisha (paraardhësi i parashtruesve të kërkesës) kishte lidhur një kontratë [Vr.nr.2923] të shitblerjes së pronës me M. I. K. e cila evidentohej si ngastra kadastrale [1902/1]. Kjo kontratë ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale, mirëpo asnjëherë nuk ishte regjistruar në regjistrat kadastrale.
13. Më 6 tetor 1975, nga procesverbali mbi marrjen në pyetje [nr. 07-465-39173-72], i përpiluar nga Sekretariati për Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në lidhje me eksproprijimin e ngastrës kadastrale [1902/3], konstatohet se ishte mbajtur shqyrtim publik, ku pronari legjitim i paluajtshmërisë, personi R. K., kishte theksuar se nuk e kishte kundërshtuar eksproprijimin për nevojat e *"Ibër Lepencit"*, por kishte sqaruar se ngastrën kadastrale në fjalë pjesërisht ia kishte shitur Sh. G. nga Prishtina dhe pjesërisht ia kishte shitur, respektivisht e kishte ndërruar me S. E. nga Keqekolla.
14. Më 4 gusht 1976, Sekretariati për Ekonomi dhe Financa i Kuvendit Komunal të Prishtinës, përmes Aktvendimit [07.Nr.465-39/73] për interes publik, gjegjësisht për nevojat e ndërtimit të sistemit të *"Ibër Lepencit"*, kishte eksproprijuar ngastrat kadastrale me [nr. 1902/3], me sipërfaqe prej 00.7.41 ha, arë e klasit të tretë. Nga Aktvendimi i lartpërmendur dhe nga lista poseduese me [nr. 4008] e 23 majit 1973, vërtetohej se pronar i regjistruar i kësaj paluajtshmerie, në atë kohë, ishte R. K., i cili evidentohej nën numrin rendor 72 dhe organ shpronësues ka qenë Sekretariati për Ekonomi dhe Financa i KK Prishtinës. Në pjesën e fundit të këtij Vendimi, thuhej se *"Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë Drejtorisë Krahinore për punë pronësore-juridike në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit."*
15. Më 17 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C.nr.1969/07] parashtruesve të kërkesës ua vërtetoi pronësinë në ngastrat kadastrale: [1902-2, sipërfaqe S=0.02.10ha] dhe [1902-1, sipërfaqe 1.98.03 ha]. Pronësia u ishte vërtetuar bazuar në nenin 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore, gjegjësisht në bazë të parashkrimit fitues, posedimit të pandërprerë dhe me mirëbesim për njëzet vite nga ana e parashtruesve të kërkesës.
16. Më 3 korrik 2012, parashtruesit e kërkesës dorëzuan padi në Gjykatën Themelore përmes së cilës kërkonin që të detyrohet e paditura N.H. *"Ibër Lepenci"*, që parashtruesve në emër të kompensimit të paluajtshmërisë së eksproprijuar me Aktvendimin [07.Nr.465-39/73], të 4 gushtit 1976, e cila evidentohej si njësi kadastrale me nr. [1902/3], tani pjesë e ngastrës kadastrale me nr. [7793], vendi i quajtur *"Shelgje"*, zona kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe prej 700 m<sup>2</sup>, si dhe ngastrës kadastrale me nr. [1902/3], vendi i quajtur *"Shelgje"*, zona kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe prej 210 m<sup>2</sup>, e cila nuk mund të shfrytëzohet nga parashtruesit për shkak të ndarjes nga ngastra kryesore dhe për shkak të sipërfaqes së vogël dhe formës jo të rregullt, t'ua kompensoje dhe atë: për ngastrën kadastrale me nr. [1902-3], tani pjesë e ngastrës kadastrale me nr. [7793-0], shumën prej 81,161.73 euro, (tetëdhjetë e njëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e tre cent) dhe për ngastrën kadastrale me nr. [1902-2], shumën prej 23,001.30 euro, (njëzet e tremijë e një euro e tridhjetë cent) apo në shumën e përgjithshme, të rrumbullakuar, prej 104,000.00 euro

(njëqind e katër mijë), me kamatë ligjore që nga data 24 prill 2017 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

17. Në një datë të pacaktuar, e paditura "Ibër Lepenci" ka theksuar se i kishte kryer në tërësi procedurat e shpronësimit në vitet e 70-ta, dhe ky rast është përfunduar nga pronarët legjitim ku përmes Aktvendimit [07.Nr.465-39173] të 4 gushtit 1976, ishte bërë shpronësimi i parcelës [1902/3] me sipërfaqe prej [00.7.41 ha], nga poseduesi faktik dhe ligjor R. K., për interes publik, dhe tani kjo parcelë evidentohet në emër të të paditurës, me [nr. 7791-0], me sipërfaqe Prej [1.20.17 ha]. Në vijim e paditura theksonte gjithashtu që parashtruesve të kërkesës ju mungonte legjitimiteti aktiv, me kërkesën që padia të hedhet poshtë si e palejueshme, apo të refuzohet si e papabazuar.
18. Më 19 shtator 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.1748/12]: (I) refuzoi si të papabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura N.H. "Ibër Lepenci", që parashtruesve të kërkesës në emër të kompensimit të paluajtshmërisë së ekspropriuar me Aktvendimin [07.Nr.465-39173] e 4 gushtit 1976, e cila evidentohet si njësi kadastrale me [nr. 1902-3], tani pjesë e ngastrës kadastrale me [nr. 7793] vendi i quajtur "Shelgje", me sipërfaqe prej 700 m<sup>2</sup>, si dhe ngastrës kadastrale me [nr. 1902/3], vendi i quajtur "Shelgje", zona kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe prej 210m<sup>2</sup>, e cila nuk mund të shfrytëzohet nga paditësit për shkak të ndarjes nga ngastra kryesore dhe për shkak të sipërfaqes së vogël dhe formës jo të rregullt, t'ua kompensojë dhe atë: për ngastrën kadastrale me [nr. 1902-3], tani pjesë e ngastrës kadastrale me [nr. 7793-0], shumën prej 81,161.73 euro, (tetëdhjetë e njëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e tre cent) dhe për ngastrën kadastrale me [nr. 1902-2], shumën prej 23,001.30 euro, (njëzet e tremijë e një euro e tridhjetë cent) apo në shumën e përgjithshme, të rrumbullakuar, prej 104,000.00 euro (njëqind e katër mijë), me kamatë ligjore që nga 24 prilli 2017, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit; (II) Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.
19. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore arsyetonte si në vijim:

*Gjatë tërë procedurës gjyqësore, por as edhe me provat e propozuara dhe të administruara, paditësit nuk e kanë bërë të bazuar kërkesën e tyre karshi të paditurës, gjegjësisht me asnjë provë nuk kanë dëshmuar se kanë qenë pronarë të paluajtshmërisë së ekspropriuar në kohën e ekspropriimit. Përkundrazi, Gjykata me provat e administruara e të sjella nga vet palët, gjeti se një person i tretë ka qenë pronar i paluajtshmërisë dhe se i njëjti, gjatë marrjes në pyetje sipas procesverbalit nr. 07-465-39/73-72 i datës 06.10.1975, ka dhënë pëlqimin për eksproprijim. As personi në fjalë si titullar i së drejtës së pronësisë së tokës së ekspropriuar në kohën kur ka ndodhur ekspropriimi, e as pasardhësit e tij nuk janë palë të këtij procesi gjyqësor.*

*[...]*

*Gjykata nuk mundi t'ia fal besimin Kontratës me nr. Vr. 2923 e datës 31.12.1965, sepse pronësia sipas kësaj kontrate, asnjëherë nuk është regjistruar në librat përkatës kadastral, rrjedhimisht, si e tillë nuk mund të shërben si bazë që Gjykata të njohë pronësinë e Paditësve për pronën e ekspropriuar. Madje, nga provat e administruara, përkatësisht nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1969/07 i datës 17.12.2010, Gjykata konstatoi me saktësi se paluajtshmëria e*

*ekspropriuar nuk ka qenë objekt kërkesë i paditësve as në procedurën gjyqësore për vërtetimin e pronësisë sipas aktgjykimit të lartpërmendur.*

*Fakti që Paditësit e kanë vërtetuar dhe regjistruar pronësinë e tyre në dy ngastrat tjera, nuk u jep atyre të drejtë të supozojnë se ky vërtetim pronësie mbi ngastrat tjera, do të thotë ekzistim i pronësisë edhe mbi ngastrën e ekspropriuar. Aq më tepër kur bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1969/07 i datës 17.12.2010, pronësia mbi ato ngastra është vërtetuar mbi bazën e parashkrimit fitues dhe posedimit me mirëbesim mbi 20 vite, në përputhje me Nenin 40 të LPDS. Rrjedhimisht, pronësia e paditësve mbi ngastrat në fjalë është konstituuar në momentin kur Aktgjykimi në fjalë është bërë i plotfuqishëm, dhe jo retroaktiv - në momentin e futjes në posedim faktik.*

20. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesit e kërkesës dorëzuan ankesë: (i) për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale; duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia, apo të priset aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rigjykim.
21. E paditura "Ibër Lepenci" paraqiti përgjigje në ankesë, duke propozuar që ankesa e parashtruesve të kërkesës të refuzohet dhe Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.
22. Më 16 tetor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC.nr.5441/17] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesve të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit theksonte si në vijim:

*Nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësve se paraardhësi i paditësve me ish pronarin e paluajtshmërisë së shpronësuar ka lidhë kontratë të shitblerjes e cila e ka cilësinë e punëve të vlefshme juridike sepse është lidhë krejtësisht në pajtim me dispozitat e Ligjit Mbi Qarkullimin e Paluajtshmërive, është lidhë në formë të shkruar, është vërtetuar në gjykatën kompetente dhe se në kohën kur është lidhur kontrata nuk kanë ekzistuar librat e tokës, por ka ekzistuar vetëm regjistri kadastral i cili nuk ka pasur karakterin e librit me të cilin janë fituar të drejtat pronësore, mirëpo gjykata e apelit vlerëson se një ndër kushtet e fitimit të pronësisë ka qenë edhe regjistrimi në regjistrat kadastral, për t'u plotësuar kushti ligjor i fitimi të pronësisë.*

23. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës në afat ligjor paraqitën kërkesë për revizion: (i) për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme, ta pranojë revizionin si të bazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
24. E paditura "Ibër Lepenci" ka paraqitur përgjigje në kërkesën për revizion, duke i kontestuar shkaqet e parashtruara në revizion, me propozim që i njëjti të refuzohet.
25. Më 20 prill 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.244/2021] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesve të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të

Gjykatës së Apelit. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme ndër të tjera theksoi si në vijim:

*Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se duke marrë parasysh këtë gjendje të vërtetuar faktike, bazuar në nenin 371, i LMD-së, të vjetër, kërkesa e paditësve edhe nën supozimin e se paraardhësi i tyre ka pasur të drejtën e pronësisë, është e parashkruar si kërkesë, për faktin se në këtë dispozitë ligjore parashihet që kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit, ndërsa duke marrë parasysh faktin se aktvendimi 07.Nr.465-39/73, i Sekretariatit për Ekonomi dhe Financa i Kuvendit Komunal të Prishtinës, me të cilin është ekspropriuar paluajtshmëria për të cilën kërkohet kompensimi, është i datës 04.08.1976, ndërsa me këtë vendim është krijuar baza për kompensim për pronarët e paluajtshmërisë së ekspropriuar, dhe nga kjo datë kur ky vendim është bërë i plotfuqishëm ka filluar të ecë afati i parashkrimit, që nënkupton se deri në ngritjen e padisë nga paditësit me datë 03.07.2012, kanë kaluar mbi 35 vite.*

*[...] por këto pretendime janë tërësisht të pa bazuara për faktin se në këtë çështje nuk është objekt shqyrtimi i kërkesëpadisë nëse paditësit apo paraardhësi i tyre, ka qenë pronarë në momentin e ekspropriimit, por edhe nën këtë supozim se ka qenë pronarë kërkesa për kompensim është e parashkruar.*

### **Pretendimet e parashtruesve të kërkesës**

26. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i kontestuar, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
27. Parashtruesit e kërkesës fillimisht kontestojnë vendimet e gjykatave të rregullta duke pretenduar se të njëjtat kanë dështuar që ti sigurojnë parashtruesve një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të rastit me çka edhe kanë bërë shkelje të (I) nenit 31 të Kushtetutës, për sa i përket (i) vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale; si dhe për sa i përket (ii) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor.

#### ***(I.i) Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për sa i përket vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit***

28. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksonin që janë të pasakta "konstatimet e gjykatave të instancave më të ulëta se gjoja ata në kohën kur ishte bërë ekspropriimi i ngastrës kontestuese, nuk ishte pronar legjitim i saj, por pronar paska qenë Lah Rushiti, i cili si i tillë figuronte në regjistrin kadastral, se paditësit nuk kishin parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të Sekretariatit për Ekonomi dhe Financa të Komunës së Prishtinës me të cilën ishte ekspropriuar ngastra kontestuese, se gjoja kërkesa e paditësve për të kërkuar kompensimin e ngastrës, së ekspropriuar qenka parashkruar etj."
29. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë që Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë gabim në zbatim dhe interpretim të ligjit, kur në prani të kontratës perfekte për shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur midis paraardhësit të paditësve, tani të ndjerit Avdi Berisha dhe Mehmedali Ilaz Kadri, kur çështjen nuk e ka trajtuar në pajtim me Ligjin, Federativ për

qarkullimin e tokave dhe ndërtesave, (Gazeta, Zyrtare e RFPJ nr.26/54), sipas të cilit qarkullimi i patundshmërive ka qenë i lirë dhe se i vetmi kusht për vlefshmërinë e qarkullimit ka qenë që kontrata të jetë e lidhur në formë të shkruar. Rrjedhimisht, sipas parashtruesve të kërkesës Gjykata Supreme bën zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit duke e trajtuar rastin sipas nenit 33 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore dhe juridike pronësore, pasi që ky ligj nuk ishte në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës në vitin 1965.

30. Parashtruesit e kërkesës në vijim theksonin se *“gjykatat e rregullta nuk u morën me deklaratën e Rashit Lah Krasniqi të dhënë në procesverbalin mbi marrjen në pyetje të 06.10.1975 në të cilën theksonte se këtë tokë e kishte tjetërsuar duke ia shitur një pjesë Shefki Govorit kurse pjesën tjetër e ka ndërruar me Selim Eminin. Pra, parashtruesit theksonin se nga kjo situatë nuk kanë ekzistuar kushtet ligjore që Rashit Lah Krasniqi të merret si pronar i paluajtshmërisë së eksproprijuar, e aq më pak si pronar legjitim, siç e quajnë gjykatat. Vetëm fakti se ai e ka mohuar pronësinë në paluajtshmërinë lëndore ka mjaftuar që të vërtetohet se pronar i vërtetë i asaj paluajtshmërie është dikush tjetër gjë që ka përfaqësuar detyrim për eksproprijuesin që ta identifikoj atë. Kjo nuk ka qenë e vështirë të bëhet kur në posedim të paluajtshmërisë së eksproprijuar ishin paditësit në cilësi të pronarëve legjitim, e drejtë kjo e fituar me kontratën për shitblerjen. Si rrjedhojë, sipas dispozitave të Ligjit për eksproprijimin, e drejta në kompensim të pjesës së eksproprijuar të ngastrës kadastrale me nr.1902, u ka takuar vetëm paditësve.”*
31. Në vijim parashtruesit e kërkesës ngrenë pretendime edhe për sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit, në momentin kur gjykatat e rregullta theksonin që *“paditësit nuk e paskan shfrytëzuar të drejtën ligjore për ta ankimuar aktvendimin e organit shpronësues në afatin e paraparë, për se aktvendimi na qenka bërë i plotfuqishëm”,* ndërsa gjykatat asnjëherë nuk ua kishin dërguar atyre këtë aktvendim për eksproprijim.
32. Në kuadër të kësaj kategorie të pretendimeve, parashtruesit e kërkesës theksonin që *“te rastet e eksproprijimit të paluajtshmërive e drejta apo kërkesa për kompensimin e paluajtshmërisë së eksproprijuar nuk i nënshtrohet parashkrimit i cili është paraparë me nenin 371 të LMD siç gabimisht konstaton Gjykata Supreme.”*
33. Sipas parashtruesve të kërkesës *“e drejta e pronarit për të kërkuar kompensimin e paluajtshmërisë së eksproprijuar dhe detyrimi i shfrytëzuesit të eksproprijimit për pagesën e pronës së eksproprijuar si dhe procedura e kompensimit është paraparë me dispozitat e neneve 28 -68 të Ligjit për eksproprijimin, mirëpo me to nuk është paraparë ndonjë afat i parashkrimit të së drejtës apo kërkesës në kompensim.”*

***(I.ii) Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për sa i përket vendimit të paarsyetuar gjyqësor***

34. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se në vendimin e kontestuar ka mungesë arsytimi pasi që nuk janë dhënë kurrfarë arsyesh *“se në praninë e kontratës perfekte për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese, sipas Ligjit për qarkullimin e tokave dhe ndërtesave të vitit 1954, cili ishte raporti juridik i blerësit me paluajtshmërinë e blerë dhe nuk shpjegohet se çfarë rëndësie kishte për vendosjen e rastit deklarata e Rashit Lah Krasniqi të dhënë në procesverbalin për dëgjim publik ku kishte deklaruar se paluajtshmëria kontestuese nuk ishte pronë e tij. Gjithashtu Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj nuk jep sqarime se a ka mund gjykata e shkallës së parë çështjen ta trajtoj sipas nenit 33 të LMTHJP, pasi që ky ligj nuk ishte në fuqi në kohën kur është lidhë kontrata për shitblerjen dhe, edhe pse ishte kërkesë e revizionit, nuk ka sqaruar se çfarë*

*efektesh juridike lidhur me të drejtat në paluajtshmerinë kontestuese kishte regjistrimi i paluajtshmerive në regjistrin kadastral etj.”*

**(II) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 46 të Kushtetues në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së**

35. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Gjykata Supreme kishte bërë gabimin e radhës në trajtimin dhe vendosjen e çështjes kur atë nuk e ka trajtuar edhe në pajtim me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së (pa specifikuar ndonjë vendim konkret) me të cilat janë vendosur raste identike apo të ngjashme me rastin e tyre, e që kanë të bëjnë me të drejtën e paditësve në kompensimin e pronës së ekspropriuar e të cilat rregulla dhe vendime, sipas nenit 22 të Kushtetutës kanë qenë obliguese për gjykatat e rregullta.

**(III) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës**

Parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se gjykatat e rregullta me injorimin e fakteve dhe provave të paraqitura nga ana e tyre në ankesë dhe në revizion e të cilat ishin paraqitur edhe gjatë seancave të mbajtura gjyqësore pranë gjykatës së shkallës së parë si dhe me interpretimin dhe zbatim të gabuar të dispozitave ligjore në fuqi, Gjykata Supreme ka dështuar që të siguroj barazinë para ligjit për paditësit me çka ka bërë shkeljen edhe të nenit 24 të Kushtetutës.

36. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: Aktgjykimin e kontestuar ta anuloj dhe çështjen *“t’ia kthej Gjykatës Supreme në rivendosje me rekomandim që ti eliminoj shkeljet e kushtetutës dhe ligjeve të pasqyruara në kërkesë, përkatësisht që me zbatim dhe interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të siguroj gjykim të drejtë dhe të paanshëm të çështjes.”*

**Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

**Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

**Neni 24 [Barazia para Ligjit]**

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

**Neni 31**

**[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**



1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

#### **Neni 46**

##### **[Mbrojtja e Pronës]**

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

##### **Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ e RSFJS-ë, 8 shkurt 1980)**

#### **Neni 28 [pa titull]**

[...]

*Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.*

### **Neni 37 [pa titull]**

*Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale.*

*Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktit të të paditurit.*

*E drejta e paraqitjes së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

37. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

39. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

#### **Neni 47 (Kërkesa individuale)**

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”*

[...]

#### **Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)**

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

40. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr. 244/2021] e 20 prillit 2022, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

41. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 34 (2) parasheh:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”*

42. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtrues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26 shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

43. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta.”

44. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

45. Në dritën e këtij sfondi normativ, Gjykata sjell në vëmendje se çështja thelbësore në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me pretendimin e parashtruesve të kërkesës lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatave të rregullta, nën pretendimin se babai i tyre ishte pronar i një toke e cila ishte blerë përmes kontratës së shitblerjes në vitin 1965, e cila pronë sipas tyre në vitin 1976 ishte eksproprijuar për qëllim të ndërtimit të sistemit të Ibër Lepencit. E njëjta kontratë e vitit 1965 nuk ishte regjistruar asnjëherë në regjistrat kadastralë. Parashtruesit përmes padisë kërkonin nga i padituri Ibër Lepenci pagesën e vlerës së kompensimit të pronës në fjalë për të cilën kishin pretendime se ishin pronarë të saj. Gjykata Themelore kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës nën arsyetimin se nuk arritën ta bazonin kërkesën e tyre karshi të paditurës, se të njëjtit kanë qenë pronar të pronës së eksproprijuar në kohën kur ishte bërë eksproprijimi. Ndërsa, prona në fjalë ishte e evidentuar nën pronësinë e palëve tjera. Pra, Gjykata Themelore konstatoi që nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1969/07 i datës 17.12.2010, paluajtshmëria e eksproprijuar nuk ka qenë objekt kërkesë i parashtruesve të kërkesës as në procedurën gjyqësore për vërtetimin e pronësisë sipas aktgjykimit të lartpërmendur. Pas refuzimit të kërkesëpadisë nga Gjykata Themelore, pasoi edhe refuzimi si e pathemeltë e ankesës së parashtruesit të kërkesës nga ana e Gjykatës së Apelit. Përfundimisht, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesve të kërkesës.
46. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të (I) nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si rezultat i (i) vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar të ligjit; dhe (ii) vendimit gjyqësor të paarsyetuar; (II) shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së; si dhe (III) Pretendimet për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

***(I.i) Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për sa i përket vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit***

47. Parashtruesi i kërkesës, i konteston para Gjykatës konstatimet e gjykatave të rregullta, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, vë theks në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të Ligjit, për arsyet vijuese: (i) mos pranimit i kontratës për shitblerjen e patundshmërisë e vitit 1965; (ii) zbatim i gabuar i ligjit lidhur me mos shfrytëzimin e të drejtës ligjore për ta ankimuar aktvendimin e organit shpronësues në afatin e paraparë, prej nga aktvendimi ishte bërë i plotfuqishëm; (iii) kërkesa për kompensimin e paluajtshmërisë së eksproprijuar nuk i nënshtrohet parashkrimit i cili është paraparë me nenin 371 të LMD siç gabimisht konstaton Gjykata Supreme.
48. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata thekson se të njëjtat në esencë ndërlidhen me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm nga Gjykata Supreme, pretendime të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si "*pretendime të shkallës së katërt*".
49. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, (shih, në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në

merita; A. Kërkesat Qartazi te Pabazuara; 2."Shkalla e katërt", paragrafët 281 dhe 288), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI96/21](#), parashtrues Xhelal Zherka, Aktvendim për Papranueshmëri i 23 shtatorit 2021, paragrafi 49; [KI145/20](#), parashtrues *Hafize Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 33; [KI179/18](#), parashtrues *Belgjyjar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

50. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI145/20](#), cituar më lartë, paragrafi 34; [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 61).
51. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 janarit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërliidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin përkatës.
52. Në këtë kontest, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtruesve të kërkesës ndërliidhen me interpretimin e gabuar të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore dhe juridike pronësore nga ana e Gjykatave të rregullta, si dhe me mos pranimin e kontratës për shitblerjen e patundshmërisë e vitit 1965.
53. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.1748/12] të 19 shtatorit 2017, kishte theksuar si në vijim:

*Gjykata nuk mundi t'ia fal besimin Kontratës me nr. Vr. 2923 e datës 31.12.1965, sepse pronësia sipas kësaj kontrate, asnjëherë nuk është regjistruar në librat përkatës kadastral, rrjedhimisht, si e tillë nuk mund të shërben si bazë që Gjykata të njohë*

pronësinë e Paditësve për pronën e eksproprijuar. Madje, nga provat e administruara, përkatësisht nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1969/07 i datës 17.12.2010, Gjykata konstatoi me saktësi se paluajtshmëria e eksproprijuar nuk ka qenë objekt kërkesë i paditësve as në procedurën gjyqësore për vërtetimin e pronësisë sipas aktgjyqimit të lartpërmendur.

Edhe sikur gjykata ta konsideronte si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, padia e tyre është bërë përtej të gjitha afateve të mundshme ligjore, madje duke u tejkaluar të njëjtit për më shumë se tri herë. Sepse nga Aktvendimi 07.Nr.465-39/73, i datës 04.08.1976, rezulton se në bazë të nenit 21 të Ligjit për Eksproprijim, Paditësit po që se do ta konsideronin veten pronar të paluajtshmërisë, kanë mundur të kërkojnë anulimin e këtij vendimi për eksproprijim të pronës së paluajtshme nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit (e Paditura) në afatin prej 3 vitesh prej se vendimi ka marrë formë të prerë, dhe po që se nuk ka kryer sipas natyrës së objektit, punime të nevojshme në atë objekt. Apo pasi të kalojë afati prej 10 vitesh nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi eksproprijimin, nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e atij vendimi. Ndërsa paditësit nuk e kanë ndërmarr asnjë veprim procedural lidhur me eksproprijimin lëndor përderisa kanë ushtruar padi në këtë gjykatë në vitin 2012, që i bie mbi 30 vite pas eksproprijimit.

54. Duke adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit përmes Aktgjyqimit [AC.nr.5441/17] të 16 tetorit 2020, kishte dhënë arsyet e refuzimit të ankesës, duke theksuar si në vijim:

Nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësve se paraardhësi i paditësve me ish pronarin e paluajtshmërisë së shpronësuar ka lidhë kontratë të shitblerjes e cila e ka cilësinë e punëve të vlefshme juridike sepse është lidhë krejtësisht në pajtim me dispozitat e Ligjit Mbi Qarkullimin e Paluajtshmërive, është lidhë në formë të shkruar, është vërtetuar në gjykatën kompetente dhe se në kohën kur është lidhur kontrata nuk kanë ekzistuar librat e tokës, por ka ekzistuar vetëm regjistri kadastral i cili nuk ka pasur karakterin e librit me të cilin janë fituar të drejtat pronësore, mirëpo gjykata e apelit vlerëson se një ndër kushtet e fitimit të pronësisë ka qenë edhe regjistrimi në regjistrat kadastral, për t'u plotësuar kushti ligjor i fitimit të pronësisë.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të aut. të paditësve për zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Mbi bazë të gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë drejtë janë zbatuar edhe dispozitat e së drejtës materiale.

Me dispozitën e nenit 11 të Ligjit për Eksproprijim, shpërblimi për tokën e eksproprijuar i paguhet pronarit të tokës.

55. Përfundimisht, Gjykata Supreme përmes Aktgjyqimit [Rev.nr.244/2021] të 20 prillit 2022, duke adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës kishte dhënë arsyet e refuzimit të revizionit, duke theksuar si në vijim:

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se duke marrë parasysh këtë gjendje të vërtetuar faktike, bazuar në nenin 371, i LMD-së, të vjetër, kërkesa e paditësve edhe nën supozimin e se paraardhësi i tyre ka pasur të drejtën e pronësisë, është e parashkruar si kërkesë, për faktin se në këtë dispozitë ligjore parashihet që kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i

*parashkrimit, ndërsa duke marrë parasysh faktin se aktvendimi 07.Nr.465-39/73, i Sekretariatit për Ekonomi dhe Financa i Kuvendit Komunal të Prishtinës, me të cilin është ekspropriuar paluajtshmëria për të cilën kërkohet kompensimi, është i datës 04.08.1976, ndërsa me këtë vendim është krijuar baza për kompensim për pronarët e paluajtshmërisë së ekspropriuar, dhe nga kjo datë kur ky vendim është bërë i plotfuqishëm ka filluar të ecë afati i parashkrimit, që nënkupton se deri në ngritjen e padisë nga paditësit me datë 03.07.2012, kanë kaluar mbi 35 vite.*

*[...] por këto pretendime janë tërësisht të pa bazuara për faktin se në këtë çështje nuk është objekt shqyrtimi i kërkesëpadisë nëse paditësit apo paraardhësi i tyre, ka qenë pronarë në momentin e eksproprijimit, por edhe nën këtë supozim se ka qenë pronarë kërkesa për kompensim është e parashkruar.*

56. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar kishte vërtetuar vendimet e instancave më të ulëta, në rrethanat e rastit konkret, kishte trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë edhe ato që ndërliken me interpretimin e gabuar të dispozitave ligjore.
57. Prandaj, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ta, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk dëshmojnë dhe nuk mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre se gjykatat e rregullta mund të kenë aplikuar ligjin në mënyrë të gabuar, dhe rrjedhimisht pretendimet e tyre për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e "*shkallës së katërt*" dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të "*ligjshmërisë*" dhe nuk janë argumentuar në nivel të "*kushtetutshmërisë*". Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
58. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, Gjykata thekson se "*drejtësia*" që kërkohet përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi "*substanciale*", por drejtësi "*procedurale*". Në terma praktik kjo shprehet përmes procedurës kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës. (Shih rastin e Gjykatës: [KI131/19](#), parashtrues *Sylë Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 57; dhe [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 55).
59. Kjo më saktësisht nënkupton, se palëve përgjatë një procedure të drejtë dhe të paanshme duhet të: (i) u mundësohet zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; (ii) u akordohet mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë relevante për rastin përkatës; (iii) u garantohet se të gjitha argumentet dhe dëshmitë, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat përkatëse; (iv) u garantohet se faktet dhe pretendimet ligjore në vendimet gjyqësore ishin shqyrtuar dhe arsyetuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, (v) u garantohet se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe jo arbitrare. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lartë, paragrafi 29; dhe [KI131/19](#), cituar më lart, paragrafi 58). Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se ky nuk është rasti.

60. Gjykata rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI118/17](#) parashtues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 54; dhe [KI99/19](#), parashtuese *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).
61. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtuesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund të ngrejë vetvetiu pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

**(I.ii) Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për sa i përket vendimit të paarsyetuar gjyqësor**

62. Parashtuesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se në vendimin e kontestuar ka mungesë arsytimi pasiqë nuk janë dhënë kurrfarë arsyesh “*se në praninë e kontratës perfekte për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese, sipas Ligjit për qarkullimin e tokave dhe ndërtesave të vitit 1954, cili ishte raporti juridik i blerësit me paluajtshmerinë e blerë dhe nuk shpjegohet se çfarë rëndësie kishte për vendosjen e rastit deklarata e Rashit Lah Krasniqit e dhënë në procesverbalin për dëgjim publik ku kishte deklaruar se paluajtshmeria kontestuese nuk ishte pronë e tij. Gjithashtu Gjykata Supreme në aktgjykimin e sajë nuk jep sqarime se a ka mund gjykata e shkallës së parë çështjen ta trajtoj sipas nenit 33 të LMTHJP, pasi që ky ligj nuk ishte në fuqi në kohën kur është lidhë kontrata për shitblerjen dhe, edhe pse ishte kërkesë e revizionit, nuk ka sqaruar se çfarë efektsh juridike lidhur me të drejtat në paluajtshmerinë kontestuese kishte regjistrimi i paluajtshmerive në regjistrin kadastral etj.”*
63. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet [Hadjianastassiou kundër Greqisë](#), nr.12945/87, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 20124/92, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; [Pronina kundër Ukrainës](#), nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe [Tatishvili kundër Rusisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe [KI24/17](#), parashtues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, [KI35/18](#), parashtues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe



rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

64. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNj-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, cituar më lartë, paragrafi 44).
65. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin mbi të cilin ato bazohen në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNj-së: [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lartë, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lartë, paragrafi 27; dhe [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), cituar më lartë, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin [Moreira Ferreira kundër Portugalisë \(Nr.2\)](#), nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).
66. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo vlerëson se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës: [KI72/12](#), *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; [KI135/14](#), *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58; [KI97/16](#) *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; [KI87/18](#) parashtrues *IF Skadeforsikring*, cituar më lartë, paragrafi 44; [KI138/19](#) parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, cituar më lartë, paragrafi 138).

*i. Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*

67. Në këtë kontest, Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, çështja esenciale ndërlidhet me çështjen e (i) mos marrjes parasysh të kontratës mbi shitblerjen e pronës së vitit 1965; si dhe (ii) rëndësia që kishte për vendosjen e rastit deklarata e R. K. e dhënë në procesverbalin për dëgjim publik ku kishte deklaruar se paluajtshmëria kontestuese nuk ishte pronë e tij. Gjithashtu (iii) Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj nuk jep sqarime se a ka mund gjykata e shkallës së parë çështjen ta trajtoj sipas nenit 33 të LMTHJP, pasi që ky ligj nuk ishte në fuqi në kohën kur është lidhë kontrata për shitblerjen dhe përkundër që ishte kërkesë e revizionit, nuk ka sqaruar se çfarë efektsh juridike lidhur me të drejtat

në paluajtshmërinë kontestuese kishte regjistrimi i paluajtshmërive në regjistrin kadastral etj.

68. Në ndërlidhje me çështjet e lartcekura, Gjykata në vazhdim do t'u referohet pjesëve relevante të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, që adresojnë pretendimet e parashtruesve të kërkesës. Fillimisht, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila ka arsyetuar si në vijim:

*Gjykata nuk mundi t'ia fal besimin Kontratës me nr. Vr. 2923 e datës 31.12.1965, sepse pronësia sipas kësaj kontrate, asnjëherë nuk është regjistruar në librat përkatës kadastral, rrjedhimisht, si e tillë nuk mund të shërben si bazë që Gjykata të njohë pronësinë e Paditësve për pronën e eksproprijuar. Madje, nga provat e administruara, përkatësisht nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1969/07 i datës 17.12.2010, Gjykata konstatoi me saktësi se paluajtshmëria e eksproprijuar nuk ka qenë objekt kërkesë i paditësve as në procedurën gjyqësore për vërtetimin e pronësisë sipas aktgjykimit të lartpërmendur.*

*Edhe sikur gjykata ta konsideronte si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, padia e tyre është bërë përtej të gjitha afateve të mundshme ligjore, madje duke u tejkaluar të njëjtit për më shumë se tri herë. Sepse nga Aktvendimi 07.Nr.465-39/73, i datës 04.08.1976, rezulton se në bazë të nenit 21 të Ligjit për Eksproprijim, Paditësit po që se do ta konsideronin veten pronar të paluajtshmërisë, kanë mundur të kërkojnë anulimin e këtij vendimi për eksproprijim të pronës së paluajtshme nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit (e Paditura) në afatin prej 3 vitesh prej se vendimi ka marrë formë të prerë, dhe po që se nuk ka kryer sipas natyrës së objektit, punime të nevojshme në atë objekt. Apo pasi të kalojë afati prej 10 vitesh nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi eksproprijimin, nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e atij vendimi. Ndërsa paditësit nuk e kanë ndërmarr asnjë veprim procedural lidhur me eksproprijimin lëndor përderisa kanë ushtruar padi në këtë gjykatë në vitin 2012, që i bie mbi 30 vite pas eksproprijimit.*

69. Gjykata më tutje i referohet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e cila pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës i arsyetoi si në vijim:

*Nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësve se paraardhësi i paditësve me ish pronarin e paluajtshmërisë së shpronësuar ka lidhë kontratë të shitblerjes e cila e ka cilësinë e punëve të vlefshme juridike sepse është lidhë krejtësisht në pajtim me dispozitat e Ligjit Mbi Qarkullimin e Paluajtshmërive, është lidhë në formë të shkruar, është vërtetuar në gjykatën kompetente dhe se në kohën kur është lidhur kontrata nuk kanë ekzistuar librat e tokës, por ka ekzistuar vetëm regjistri kadastral i cili nuk ka pasur karakterin e librit me të cilin janë fituar të drejtat pronësore, mirëpo gjykata e apelit vlerëson se një ndër kushtet e fitimit të pronësisë ka qenë edhe regjistrimi në regjistrat kadastral, për t'u plotësuar kushti ligjor i fitimi të pronësisë.*

70. Po ashtu, Gjykata vëren se edhe Gjykata Supreme kishte dhënë arsyetimin e saj, ku ndër të tjera arsyetoi:

*Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se duke marrë parasysh këtë gjendje të vërtetuar faktike, bazuar në nenin 371, i LMD-së, të vjetër, kërkesa e paditësve edhe nën supozimin e se paraardhësi i tyre ka pasur të drejtën e pronësisë, është e parashkruar si kërkesë, për faktin se në këtë dispozitë ligjore parashihet që kërkesat*

parashkruhen për pesë vjet në qofinë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit, ndërsa duke marrë parasysh faktin se aktvendimi 07.Nr.465-39/73, i Sekretariatit për Ekonomi dhe Financa i Kuvendit Komunal të Prishtinës, me të cilin është eksproprijuar paluajtshmëria për të cilën kërkohet kompensimi, është i datës 04.08.1976, ndërsa me këtë vendim është krijuar baza për kompensim për pronarët e paluajtshmërisë së eksproprijuar, dhe nga kjo datë kur ky vendim është bërë i plotfuqishëm ka filluar të ecë afati i parashkrimit, që nënkupton se deri në ngritjen e padisë nga paditësit me datë 03.07.2012, kanë kaluar mbi 35 vite.

[...] por këto pretendime janë tërësisht të pa bazuara për faktin se në këtë çështje nuk është objekt shqyrtimi i kërkesëpadisë nëse paditësit apo paraardhësi i tyre, ka qenë pronarë në momentin e eksproprijimit, por edhe nën këtë supozim se ka qenë pronarë kërkesa për kompenzim është e parashkruar.

71. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë adresuar dhe u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve relevante të parashtruesve të kërkesës të ngritura përmes padisë, ankesës dhe revizionit, në lidhje me çështjen e mos marrjes parasysh të kontratës së shitblerjes së pronës së vitit 1965, si dhe çështjes së zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me ç’ rast ka vlerësuar se gjykatat kanë pasur prova të mjaftueshme dhe bindëse që mbështesin konkluzionin e tyre përkitazi me vendimmarrjen në çështjen e parashtruesve të kërkesës.
72. Gjykata, dëshiron të rikujtojë gjithashtu se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohet përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GjEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lartë; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lartë, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, nr. 40490/98, Vendim i 29 gushtit 2000, paragrafi 81).
73. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNJ-së: *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës: [KI128/19](#), parashtrues *Artan Mala*, Aktvendim për Papranueshmëri i 25 shkurtit 2021, paragrafi 58; dhe [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
74. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesve të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta. Parashtruesit e kërkesës edhe me tej mund të mos jenë të kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tyre, megjithatë, kjo pakënaqësi vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me

Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

75. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për *vendim të arsyetuar*, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, si të tilla i takojnë kategorisë së pretendimeve qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në *"mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"* ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.
76. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

***(II) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 46 të Kushtetues në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së***

77. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
78. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Gjykata Supreme kishte bërë gabimin e radhës në trajtimin dhe vendosjen e çështjes kur atë nuk e ka trajtuar edhe në pajtim me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së (pa specifikuar ndonjë vendim konkret) me të cilat janë vendosur raste identike apo të ngjashme me rastin e tyre, e që kanë të bëjnë me të drejtën e paditësve në kompensimin e pronës së ekspropriuar e të cilat rregulla dhe vendime, sipas nenit 22 të Kushtetutës kanë qenë obliguese për gjykatat e rregullta.
79. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës, sikundër edhe neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) i KEDNJ nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih rastet e Gjykatës: KI201/18, me parashtrues *Selami Taraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 nëntorit 2019, paragrafi 39; [KI83/18](#), me parashtrues *Ivica Milosevic*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 tetorit 2019, paragrafi 41; Shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: [Van der Mussele kundër Belgjikës](#), nr. 8919/80, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; dhe [Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë](#), nr. 48321/99, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
80. Në këtë kuadër, Gjykata i referohet interpretimeve të GJEDNJ, ku vihet në pah se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) i KEDNJ-së vlen vetëm për *"zotërimet"* ekzistuese të një personi (shih rastet e GJEDNJ-së: [Marckx kundër Belgjikës](#), nr. 6833/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, paragrafi 50; [Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë](#), nr. 73049/01, Aktgjykimi i 11 janarit 2007, paragrafi 64).
81. Parashtruesit e kërkesës më tej mund të pretendojnë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për atë që vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me *"pronën"* e tij; brenda kuptimit të kësaj dispozite *"pronë"* mund të jetë *"pasuria ekzistuese"*, duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë *"pritshmëri legjitime"* që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore.
82. Në rrethana të caktuara, një *"pritshte legjitime"* për të marrë një pronë mundet gjithashtu të gëzojë mbrojtje nga Neni 1 i Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së: [Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës](#), nr. 17849/91, Aktgjykimi i

20 nëntorit 1995, paragrafi 31; *Grazinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, nr. 39794/98, Vendim për papranueshmëri i 10 korrikut 2002, paragrafi 73).

83. Por, sipas praktikës së GJEDNJ, nuk mund të thuhet se lind ndonjë "pritje legjitime" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesat e parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih rastin e GJEDNJ-së: *Kopecky kundër Sllovakisë*, nr. 44912/98, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafi 50).
84. Në këtë drejtim, Gjykata duke i trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje edhe me parimet e lartpërmendura të të drejtës në pronë, vëren se parashtruesi nuk e ka arsyetuar në veçanti shkeljen e së drejtës së pronës dhe nuk i referohen konkretisht ndonjë prej parimeve të përmbajtura në nenin 46 të Kushtetutës, por konsideron se kjo e drejtë i është shkelur si pasojë e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe në këtë mënyrë nuk kanë vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë së tij.
85. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, në rrethanat e rastit konkret, kishin trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë edhe ato që ndërlidhen me interpretimin e gabuar të dispozitave të ligjit të aplikueshëm. Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
86. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale Gjykata tashmë ka ardhur në përfundim se këto pretendime janë qartazi të pabazuara. Prandaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk dëshmohet se parashtruesit kanë kërkesë të arsyetuar lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve "të shkallës së katërt", prandaj deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 34 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

### ***(III) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës***

87. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se gjykatat e rregullta me injorimin e fakteve dhe provave të paraqitura nga ana e tyre në ankesë dhe në revizion e të cilat ishin paraqitur edhe gjatë seancave të mbajtura gjyqësore pranë gjykatës së shkallës së parë si dhe me interpretimin dhe zbatim të gabuar të dispozitave ligjore në fuqi, Gjykata Supreme ka dështuar që të siguroj barazinë para ligjit për paditësit me çka ka bërë shkeljen edhe të nenit 24 të Kushtetutës.
88. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të kësaj Gjykate dhe të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë "të pambështetura apo të paarsyetuara" ose kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
  - a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rastet e

GJEDNJ-së: [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Vendim i 31 majit 2005; dhe [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendim i 25 shtatorit 2008);

- b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës: [KI166/20](#), me parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 42).
89. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e tyre individuale dhe ka ardhur deri te shkelja e nenit 24 të Kushtetutës, mirëpo nuk shpjegojnë specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) cituar më lart, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtrues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38- 39).
90. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ky pretendim cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, pasi parashtruesi i kërkesës thjesht ka cituar një dispozitë të Kushtetutës, pa shpjeguar se si është shkelur ajo. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

## **Përfundim**

91. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës është e papranueshme, sepse (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për sa i përket (i) konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, kualifikohen si pretendime të “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendimet për vendim të paarsyetuar gjyqësor kualifikohen si pretendime qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; (II) pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, janë pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; dhe si të tilla këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, si dhe (ii) përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, deklarohen si qartazi të pabazuara, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Prandaj, kërkesa në tërësi deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2023, njëzëri:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtari raportues**



Nexhmi Rexhepi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka Nimani